



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština –Municipality of Prishtina



Në bazë të dispozitave të nenit 12, nenit 17, shkronja b), nenit 40, shkronja l) të Ligjit nr. 03/L – 040, për vetëqeverisje lokale, nenit 10, parografi 2, nënparagrafët 2.1 dhe 2.3, nenit 11, parografi 1, nënparagrafët 1.2 dhe 1.6 të Ligjit 04/L-174, për Planifikim hapësinor, Udhëzimit administrativ, nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, Udhëzimit administrativ, nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor, nenit 15, parografi 15.1. shkronja b), nenit 33, parografi 33.2, shkronja b) dhe nenit 34, parografi 34.1, shkronja d) të Statutit të Komunës së Prishtinës, 01. nr. 110-391 dt. 25.2.2010, Kuvendi i Kryeqytetit, në mbledhjen e mbajtur më 3.6.2024, merr këtë

V E N D I M
PËR MIRATIMIN E PLANIT RREGULLUES TË HOLLËSISHËM "KALABRIA" 2024-2032,
NË PRISHTINË

Neni 1
Lloji i dokumentit të planifikimit hapësinor

Miratohet Plani rregullues i hollësishëm "Kalabria" 2024- 2032, në Prishtinë.

Neni 2
Përkufizimi i dokumentit të planifikimit hapësinor

Planet rregulluese të hollësishme përcaktojnë kushtet për rregullimin e hapësirave për zona urbane apo zona rurale, si çështje e përcaktuar në Planin zhvillimor komunal dhe Hartën zonale komunale.

Neni 3
Qëllimi i hartimit

Me miratimin e Planit rregullues "Kalabria" 2024-2032, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale, dhe me mundësitet për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës për të cilën hartohet plani.

Neni 4
Kufiri i territorit

Zona për të cilën është hartuar Plani rregullues i hollësishëm përfshin një sipërfaqe prej S=355 ha.

Neni 5
Kriteret e zhvillimit të zonës

Parametrat e Planit rregullues të hollësishëm janë të përcaktuar sipas hartës “Shfrytëzimi i planifikuar i tokës”.

Neni 6
Subjekti përgjegjës për hartim

Bartës i hartimit të Planit rregullues “Kalabria” 2024-2032, është Drejtoria e Planifikimit, Urbanizmit dhe Mjedisit.

Neni 7
Afati i vlefshmërisë

Plani rregullues i hollësishëm mbalon një periudhe prej së paku 8 (tetë) vjeçare.

Neni 8
Gjuha zyrtare

Plani Rregullues i hollësishëm “Kalabria” 2024-2032, është në gjuhë zyrtare dhe së paku në 3 (tri) kopje të shtypura dhe të vulosura dhe 3 (tri) kopje digitale të originalit.

**Neni 9
Programi**

Pjese e këtij vendimi është programi për hartimin dhe menaxhimin e procesit të planifikimit, i paraparë sipas nenit 11, paragrafi 1, nënparagrafi 1.3 të Ligjit për planifikim hapësinorë nr. 04/L-174.

**Neni 10
Hyrja ne fuqi**

Ky Vendim hyn në fuqi 15 (pesëmbëdhjetë) ditë pas regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal, si dhe 7 (shtatë) ditë pas publikimit në gjuhët zyrtare në ueb-faqen e Komunës.

**KUVENDI I KRYEQYTETIT
01-350/01-75041/24, më 10.6.2024**

**KRYESUESI I KUVENDIT
Fehmi Kupina**



A R S Y E T I M

për miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për lagjen “Kalabria”

Hyrje

Plani rregullues për lagjen “Kalabria” është miratuar me Vendimin e Kuvendit të Komunës së Prishtinës, me nr. 01-35-18196, dt. 3.8.2005. Më 27.5.2011, nr. 01-35-1146, nga ana e Kuvendit komunal është marrë vendim mbi plotësimin dhe ndryshimin e këtij plani. Në bazë të këtij Vendimi dhe pas kryerjes së procedurave të tenderimit, më 7.3.2013, është nënshkruar Kontrata në mesë të Komunës së Prishtinës dhe studios projektuese “Urban Plus”. Me shkresën ZSP – 1168/13, dt. 07.03.2013, MMPH ka pezulluar procedurën e hartimit të këtij plani deri në nxjerrjen e aktit nënligjor, i cili i përcakton kriteret për hartimin e PRRH-ve.

Pas miratimit të aktit nënligjorë nga MMPH, dhe pas konsultave të bëra në atë kohë ndërmjet DUNMM-së dhe MMPH-së, është lejuar vazhdimi i hartimit të këtij plani.

Sipas legjislacionit në fuqi, janë mbajtur edhe konsultat publike me qytetarët e lagjes në fjalë dhe, në fund është mbajtur edhe shqyrtimi publik, në të cilin nga komisioni përkatës janë shqyrtuar të gjitha vërejtjet dhe komentet e dala nga ky shqyrtim publik.

Andaj, duke u bazuar në nenin 17, pika 1 e Ligjit për planifikim hapësinor, 04/L-174, dhe duke u bazuar në kërkesën e Drejtorisë së Investimeve Kapitale të Komunës së Prishtinës, dhe kërkesave të vazhdueshme të qytetarëve për të investuar në këtë zonë, Komuna e Prishtinës ka formuar grupin punues, me përfaqësues nga Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm dhe Drejtoria e Urbanizmit, për analizë të zonës në fjalë, për inicim të procesit të hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për Zonën e lagjes “Kalabria”.

Më 25.11.2022, Kuvendi i Komunës së Prishtinës ka miratuar Vendimin, me nr. 01-350/05-257551/22, për fillimin e hartimit të Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria”, ndërsa më 26.12.2023, Kuvendi Komunal i Prishtinës ka miratuar Vendimin, me nr. 01-020/04-236505/23, për lënien në shqyrtim publik të projektdokumentit të Planit rregullues të hollësishëm “Kalabria”, në periudhë kohore prej 15 ditëve, duke përfshi nga data 22.2.2024 – 7.3.2024.

Ky plan po ashtu i ka kaluar të gjitha fazat e hartimit, i cili është hartuar nga autoriteti për planifikim hapësinorë (Komuna e Prishtinës).

Inicimi i tillë është bërë bazuar edhe në komunikimet me MMPH, përkatësisht në përgjigjen e MMPH-së, me nr.4724/18, të dt. 21.09.2018, ku thuhet se Komuna mund të hartojë plane rregulluese të hollësishme (rasti “Dodona”, blloku A1)“pasi që Udhëzimi administrativ MMPH - nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme, ka hyrë në fuqi më 14.2.2018.” dhe se Komuna duhet të bazohet në dokumentin e planifikimit hapësinor Planit zhvillimor komunal të Komunës në fuqi, dhe sipas Udhëzimit administrativ MMPH-nr. 08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor (neni 11, paragrafi 1. nënparografi 1.2 dhe nënparografi 1.6 të Ligjit). Në këtë shkresë ndër të tjera thuhet se

për hartimin e këtij plani, ne si Komunë/Kryeqytet duhet të bazohemi në dokumentin e planifikimit hapësinor, Planit zhvillimor komunal të Komunës/Kryeqytetit në fuqi, dhe sipas Udhëzimit Administrativ MMPH- nr.08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor(neni 11, parografi 1, nënparografi 1.2. dhe nënparografi 1.6. të Ligjit).

Fushëveprimi

Plani rregullues i hollësishëm do të përcaktojë kushtet ndërtimore sipas Ligjit për planifikim hapësinor 04/L-174, Udhëzimi administrativ MMPH-nr. 01/18, për elementet dhe kërkesat themelore për hartimin, zbatimin dhe monitorimin e planeve rregulluese të hollësishme dhe Udhëzimit administrativ MMPH- nr.08/2017, për normat teknike të planifikimit hapësinor dhe ligjeve të tjera në fuqi. Sipas Planit zhvillimor komunal aktual, kjo zone është e destinuar si zonë ekzistuese urbane.

Qëllimi

Me miratimin e planit, planifikohet zhvillimi hapësinor në kontekst të ndryshimeve të bëra dhe harmonizimin e tyre me nevojat reale dhe mundësitë për të arritur kushte optimale të zhvillimit dhe organizimit hapësinor, rregullimit dhe ndërtimit të zonës së përcaktuar. Zona ku është hartuar plani është një zonë, e cila ka shumë vite që nuk po mund të zhvillohet, për arsy se në këtë pjesë është e paraparë rruga dhe trajtimi i kolektorit dhe lidhja e saj me rrugën “Fatime Sokoli”, të realizuar më parë nga Komuna, dhe parcelat private që vazhdimeshit po bëhen pengesë për ndërtim të trasesë, të cilat parcela nuk po mund të shpronësohen në mungesë të mjeteve financiare.

Plani do të adresojë çështje, me qëllim të orientimit të investimeve publike dhe private, rigjallërimin e zonës, zhvillimin ekonomik, çështjet mjedisore, bonuset e dendësisë dhe zhvillimet e njësive të planifikuara etj. Me plan planifikohet t'u jepet koeficient pronave private, për ta liruar trasenë e rrugës së planifikuar dhe njëherësh për të mundësuar ndërtimin e rrugës dhe trajtimin e kolektorit, si nevojë e kahmotshme për përmirësimin e jetës së qytetarëve të kësaj zone, dhe për të cilën rrugë janë ndaluar punimet për shkaqe pronësore.

Komuna e sheh të nevojshme dhe të arsyeshme miratimin e Planit rregullues të hollësishëm për zonën e lagjes “Kalabria” – pjesa e kolektorit, i cili plan do të inkorporohet më pas në Hartën zonale të Komunës së Prishtinës.

Ky plan do të mbulojë një periudhë së paku 8 vjeçare dhe ndryshimi i tij do të bëhet sipas ligjit në fuqi.